

SFIDAT E PËRKTHIMIT SOT PËRKTHIMI DHE NDIKIMI I TIJ NË SHKENCË DHE SHOQËRI

Imer ALILI¹

¹Gjuhë dhe letërsi italijane – Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës
e-mail: imer.alili@unite.edu.mk

Abstrakt

Për sa i përket disiplinës që thuhet traduktologji apo përkthim, duhet të pranojmë po ashtu që bëhet çdo ditë e më shumë aktuale, ashtu si edhe profilizimi dhe profesionalizimi i së njëjtës saqë në vendet perëndimore ka edhe drejtime studimesh të specializuara deri edhe në shkallën e doktoratës për këtë sektor. Puna e përkthimit të teksteve të cilitdo lëmi, është zhvilluar gjithmonë gjatë perkursit të historisë së njerëzimit, që nga kohët më të lashta e deri më sot. Kjo fushë, njësoj sikurse edhe sot, i ka pasur edhe sfidat e veta jo pak të rëndësishme, ca herë edhe deri në atë shkallë sa që të nxisë edhe debate dhe mospajtime të rëndësishme të karakterit «hermeneutik» dhe vijimisht duke prodhuar edhe interpretime por edhe solidifikimin e atyre interpretimeve që pastaj kanë zënë vend dhe në të cilat edhe jemi bazuar për periudha apo edhe për epoka të tëra. Për këtë edhe nuk duhet të çuditemi kur hasim në vëllime të titulluara si “*111 gabime të përkthimit që e kanë ndryshuar botën*” të autorit Romolo Giovanni Capuano⁸, ku përshkruhen ‘incidente’ si aso për raste përkthimesh të gabuara nga tekstet origjinale në gjuhën e arritjes edhe gjërat pastaj të kenë marrë kuptimin apo edhe të jenë inkorporuar në ndonjë nismë filozofike, letrare, ideologjike e politike që në fakt, nuk kanë asgjë të përbashkët apo të ngjashme me sa ka qenë e shkruar në tekstin origjinal apo burimor. Fakte të ngjashme, po me të njëjtat gabime përkthimesh, mund të hasen akoma sot, edhe në shoqërinë njerëzore të pjekur e moderne, pra, edhe në epokën e digitalizimit.

Fjalë kyçe: përkthim, histori, kulturë, shoqëri, shkencë.

Abstract

As far as the discipline that is called translation or translatology is concerned, we must accept that it is becoming more and more current, as well as its profiling and professionalization that in western countries there are specialized study up to the doctoral level for this sector. The work of translating texts of any field has always been developing during the course of human history, from the most ancient times until today. This field, just like today, has had its challenges, not unimportant whatsoever, sometimes to the extent that it encourages important debates and disagreements of a "hermeneutic" character and subsequently producing interpretations but also the solidification of those interpretations that have subsequently taken place and on which we have relied for periods or even for entire epochs. Therefore we should not be surprised when we come across volumes like "111 translation errors that have changed the world" by Romolo Giovanni Capuano, which describes 'incidents' as such for cases of mistranslation of the original texts into a language from another language, where things then take a whole different meaning or are even incorporated into some philosophical, literary, ideological and political initiative that in fact, has nothing in common or similar to what was written in the original or source text. Similar facts, but with the same translation errors, can still be found today, even in the mature or modern human society, that is, even in the era of digitalization.

Keywords: Translation, History, Culture, Society, Science.

¹. ROMOLO GIOVANNI CAPUANO, *111 errori di traduzione che hanno cambiato il mondo* (111 gabimet e përkthimit që e kanë ndryshuar botën), Arti grafiche La Moderna, Roma 2013.

1. Hyrje

Të përkthesh çfarëdo lloj teksti, të shkruar ose të folur (simultan), është një angazhim mjaft serioz dhe që kërkon njohuri të përkryer jo vetëm të gjuhës së nisjes (Source Language) dhe të gjuhës së arritjes (Target Language), por edhe të një serë disiplinash tjera të fushës humaniste. Kjo, për faktin se duhet të mbartet apo të përkthehet ajo që francezi Doulet e kishte quajtur *dossier* atë materialin e gjuhës amë apo qoftë edhe të gjuhës së nisjes (pasi që nuk do me thënë që detyrimisht, të përkthehet çdoherë dhe vetëm nga gjuha amë). Pra, që të bëhet një përkthim i drejtë dhe pa gabime ose shtrembërime të koncepteve dhe jo vetëm i ndonjë fjale apo shprehjeje të caktuar, duhet që të njihen në mënyrë të përkryer të dyja gjuhët, pastaj sociolinguistika, psikolinguistika, semiologjia ose semantika, antropologjia, etnografia, etnologjia por edhe lënda e cila quhet filozofia e të folurit. Vetëm në këtë mënyrë dhe me një kësi soji përgatitjeje profesionale mund të bëhet fjalë për profesionist të denjë për të hy në punën e përkthyesit dhe të përkthimit.

2. Thelbi i çështjes dhe ca reflektive në lidhje me të

Mendojmë kështu për faktin se ka shkaqe të bazuara mirë kur hasim në tekste, që ndoshta, nuk kemi menduar asnjëherë se mund të trajtojnë çështje të këtilla dhe që na bëjnë të mendojmë, por, edhe të nxjerrim përfundime se ndonjë përkthim – qysh në kohët kur kanë nis të përkthehen tekste - , pra, që në kohët e hershme, që nga antikiteti me tekstet religjioze p.sh., me të cilat merret «hermeneutika», ka mundur që ndonjë tekst të mos kishte qenë i përkthyer në bazë të kriterëve të nevojshme sikurse i dimë sot, dhe vijimisht ato përkthime të jenë salduar si të mira apo edhe si të vërteta, për çka sot, do të dukej çmenduri nëse dikush ‘guxon’ t’i vërë në diskutim. Një shembull eklatant, sot, për diçka të këtillë është edhe vëllimi me titull “*111 errori di traduzione che hanno cambiato il mondo*” (111 gabimet e përkthimit që e kanë ndryshuar botën) të autorit italian Romolo Giovanni Capuano. Bëhet fjalë për një vëllim i cili i përmbledh një sërë bëmash dhe faktesh që e përfshijnë historinë e njerëzimit gjatë ecjes së vet ndër shekuj, por në veçanti janë për t’u konsideruar ato fakte që kanë ndikuar dhe e kanë ndryshuar historinë më të re të botës. Dhe, vetëm për të cekur ndonjë shembull këtu, do të shohim se si, për një gabim në përkthim prej gjuhës japoneze në anglishte, ishte vendosur dhe urdhëruar që të hidhej bomba e parë atomike në Hiroshimë, në konfliktin e Luftës së Dytë Botërore, duke shkaktuar edhe atë katakomb të tmerrshëm që e dimë të gjithë. Do të dukej si tallje, natyrisht, por jo! Ja se si shkruan në atë tekst autori i këtij libri: «*Mokusatsu* në japonishten ka dy domethënie, vetëm pjesërisht të mbivendosura. E para është: “të konsiderosh me përbuzje; të mos i varësh shumë veshin; të injorosh”. E dyta i përgjigjet në thelb anglishtes “*no comment*”, d.m.th. “nuk lëshoj komente”. Duket se përgjigja e Suzuki-t të jetë e diktuar më tepër nga vullneti që të mos komprometohet menjëherë me ushtrinë, që kundërshtonte të dorëzohej pa kushte, sesa t’u jepte një përgjigje aleatëve. Fakti qëndron se agjencitë e shtypit të të gjithë botës, duke nisur nga ato japoneze, i atribuojnë fjalës domethënien e parë. Nuk dihet kush e kishte bërë këtë zgjedhje. Ditën më pas gazetaret amerikanë shpallin se Japonia nuk e merr si të denjë deklaratën e Postdamit. Presidenti amerikan Truman, i tërbuar, duke besuar se fjalët e premierit japonez ishin shembull i radhës i

arrogancës fanatike japoneze, vendosi të kalonte në fakte. Me 6 dhe 9 gusht 1945 Hiroshima dhe Nagasaki u shkatërruan me pasojat e përshkruara më parë» (përkthimi yni).

E kam marrë dhe përkthyer këtë shembull, ndër shumë të tjerë, të përkthimit të gabuar vetëm për të vënë në pah se sa peshë të madhe ka pasur dhe ka përkthimi si profesion. Nuk është e tolerueshme dhe as është i arsyetueshëm pastaj ky fakt kaq dramatik, ku vetëm për një gabim të përkthyesit nga një gjuhë në një tjetër, të kishte shkaktuar vdekjen e disa qindra e mijëra njerëzish! Për më tepër, të gjithë e dimë se Lufta e Dytë Botërore kishte mbaruar më në atë datë të kobshme. Kjo ndodhi luftarake, pastaj ka ndikuar edhe në imagjinatën kolektive të vetë popullit japonez në radhë të parë, por edhe në opinionin publik ndërkombëtar, që nisi të mendojë nëse lufta kishte qenë e drejtë ose jo! Kështu kaluan 75 vjet nga ajo luftë, e cila u shkaktua nga një përkthyes i keq! Sa ngjarje të këtilla apo të ngjashme kanë mund të kenë ndodhë në të shkuarën e njerëzimit, a i kanë evidentuar dhe kush i ka evidentuar ato, po të ketë pasur? Sa është e vërtetë historia që e kemi mësuar ne? Atë e shkruajnë çdoherë fituesit, por duhet të konsiderohet edhe versioni i të mposhturve, i atyre që e kanë përjetuar në lëkurën e tyre, për të qenë korrekte dhe shkencore. Sepse shkenca nuk toleron rrena, ajo bazohet në fakte. Këtu nuk do të flasim për shkaqet e vërteta të interesit ekonomik, gjeopolitik dhe gjeostrategjik të Fuqive të Mëdha të asaj kohe, të përfshira në konfliktin e luftës, sepse për të na kishte rrëfyer mirë Makiaveli me tezën e njohur: “qëllimi i justifikon mjetet”, dhe do të ndalemi me kaq.

Jemi duke trajtuar këtu çështjen e të përkthyerit si profesion, si detyrë mjaft të përgjegjshme në mbartjen e materialit që e përmban një tekst në gjuhën e nisjes, nga e cila përkthehet. Ja edhe një shembull tjetër që e kemi hasur apo e kemi përjetuar drejt për së drejti: dikush (nuk do të përmendi emër këtu), ndonjë përkthyes i keq, duke e menduar përkthimin një punë të lehtë dhe që mund ta bëjë secili, e ka marrë guximin dhe hiç pa i pasur parasysh kriteret e të përkthyerit, i është dhënë këtij profesioni. I ka rënë radha të përkthejë një tekst të karakterit administrativ, pra, një vendim të Gjykatës. Fjala shpallëse është: «Одлуката е правосилна». Tani, përkthyesi, ndoshta, e di që në shqipen do bënte: “vendimi është i plotfuqishëm”, por nuk e ka parasysh fare, as prej së largu, se ka të bëhet me terminologji tekniko-specialistike të të përkthyerit dhe i drejtohet ndonjë fjalori të zakonshëm, jo edhe aq profesional, natyrisht. Duke mos qenë aty (në Fjalorth) termi specifik përgjegjës dhe adekuat, mendon që e gjen aty fjalën e ‘përafërt’ me të, në gjuhën italiane në këtë rast, por, siç thamë edhe për fjalorin edhe për mospërgatitjen profesionale të vetë përkthyesit, e fut termin e latinishtes “omnipotente” në vend që të terminologjisë juridike të italishtes që do duhej të ishte, për këtë lloj përkthimi juridik “esecutiva”!. Tani, përkthyesi i mjerë bën një sërë gabimesh gramatikore, leksikologjike dhe sintaksore: termi *omnipotente*, përpos që është në gjuhën latinisht dhe ka kuptimin e të Gjithëfuqishmit, pra të krijuesit, të Zotit, nuk i përgjigjet fare terminologjisë juridike që përdoret në rastet kur thuhet: “Vendimi është i plotfuqishëm” ose: «Одлуката е правосилна», sepse do të dukej sikur Gjykata apo gjykatësi të ishin ata që i zëvendësojnë bëmat e Zotit. Kështu u duket kur e lexojnë në gjuhën e arritjes apo në *target language*, pra krijon këtë impakt psikologjik te njerëzit e asaj gjuhe, dhe për këtë fakt “përthyesi ynë” nuk e vret mendjen aspak, sepse ai mendon vetëm për atë kompensimin e mjerë që i duhet ta inkasojë. Nuk e vret mendjen fare se si një përkthim i tillë do të ndikojë në psikologjinë e

lexuesit të asaj shkrese, e cila është bërë vetëm për një qëllim të cekët të marrë një shumë qesharake parash. Përkthimi i këtillë, ka qenë aq i pakuptimtë dhe i papranueshëm që të futet dhe ruhet në arkiva, si dokument i cili do të duhej për çdo eventualitet, për çështje kontrolli të organeve shtetërore përgjegjëse, që edhe të tregohet në raste nevojë, dhe për këtë organet e atjeshme të administratës publike e refuzojnë dhe e kthejnë prapa, në Ambasadën e Italisë. Aty, më thirrën mua personalisht dhe më drejtohen sikur unë të isha autori i atij përkthimi! Paramendoni se në çfarë gjendje të papëlqyeshme e kam ndier veten time, por, për fat të mirë, në bazë të dokumenteve të identifikimit u bindën që nuk isha unë ai përkthyesi i zymtë i atij akti gjyqësor.

Një përvojë e turpshme kjo, që nuk do ta harroj kurrë! Megjithatë, është edhe një objekt studimi për të konstatuar se si, - për shkaqe nga më të ndryshme -, një çfarëdo lloj përkthimi mund të formulohet, të publikohet dhe nganjëherë edhe të zërë vend si i tillë. Është e vërtetë se të përkryer nuk ka asgjë dhe nuk ka pasur kurrë dhe kjo na çon të mendojmë dy herë edhe për gjithë atë literaturë që është përkthyer në gjuhë të ndryshme të botës, se a është e përkthyer si duhet dhe nga profesionistë të lëndës apo edhe të ketë mundësi të përkthehen nga personazh si ky i yni dhe më pastaj edhe të kenë ngelë të tilla dhe të pranueshme nga secili vend. Kjo është ajo pyetja e madhe që pastaj na bën të dyshojmë nëse ndodhin sot veprime të tilla, pse nuk paska arsye që të kishin ndodhur edhe në të kaluarën e njerëzimit?⁹ Me këtë fushë studimesh merret shkenca që quhet *Hermeneutika*, e cila e bën interpretimin e teksteve antike. Ajo antikja, dikur, ka qenë e kohës. Pra, si mund të besojmë se p.sh., përrallat e Ezopit të kenë qenë të transkriptuara apo edhe të përkthyer me përmbajtjen e tyre që kishte synuar vetë autori ose autorët? Ne gjithnjë jemi bazuar dhe vijojmë akoma të bazohemi vetëm në ‘besimin e mirë’ të përkthyesit apo të përpiluesit të një veprë të caktuar edhe për faktin se nuk e dimë ose nuk e njohim mirë ose edhe nuk e njohim fare gjuhën e origjinës dhe na ngelet vetëm që t’i besojmë atij teksti. Por, në të kundërtën, po që se ndodh që rastësisht, ndonjë lexues ta njohë mirë gjuhën nga e cila përkthehet, mund të ndodhë që të haset edhe në përkthime mjaft të cekëta, me plot gabime dhe në disa sish edhe të arrijë deri në shtrembërimin e tërësishëm të tij. Dhe këtu lind kureshtja, përse na qenka dashur që të shtrembërohet ndonjë përkthim i caktuar dhe përse nuk ka qenë i korrigjuar eventualisht!? Kjo është ajo pyetja e madhe. Nuk është hetuar nga askush apo është hetuar por, nuk kanë dashur ta korrigjojnë sepse nuk e kanë lejuar dhe mundësuar kushtet historiko-politike?

Përrallat e Ezopit, p.sh., duhet të vijohet akoma t’u rrëfohen fëmijëve më të vegjël për t’i vënë në gjumë apo duhet t’i lexojmë dhe rilexojmë edhe ne të rriturit për të medituar pak se si është e mundur që p.sh., ujku ta akuzojë qengjin se i turbullon ujin, kur që është ujku ai i cili ndodhet në pozitën e epërme nga ku rrjedh uji dhe se qengji edhe po të dëshironte, për absurd, nuk do të kishte ndonjë mundësi as teorike që t’ia turbullonte ujin ujkut. Pra, duam të themi se është i nevojshëm çdoherë një lexim kritik i çfarëdo teksti që e hasim para vetes dhe jo vetëm të merret

²DIETER FREUNDLIEB, *The difference between science and hermeneutics: Habermas’s theory of the necessarily normative nature of linguistic interpretation*. «They are said to be equivalent to mere translation manuals because they cannot really say what knowing the meaning of an expression consists in without already presupposing knowledge of the language into which the original expressions are translated by the semantic theory», Michael Dummett, “What is a Theory of Meaning” in S. Guttenplan (ed.), *Mind and Language*, Oxford: Clarendon Press, 1975, p.103.

dhe konsiderohet gjithnjë si ndonjë libër i shenjtë, i shkruar nga Zoti, që nuk gabon asnjëherë. Më falni, edhe ato (librat e shenjtë) janë katër versione tanimë! Janë shkruar, rishkruar dhe përkthyer nga personazh të ndryshme gjatë kalimit të kohës dhe kanë provokuar kundërthënie, kundërshtime, interpretime të ndryshme dhe formulime apo sajime me ithtarë të ndryshëm, duke themeluar sekte, nënsekte, mbisekte të ndryshme. Një babel besimesh, saqë të mos dihet më se cilit popull t'i referohet Krijuesi.

Tani, po t'i marrim dhe studiojmë më seriozisht dhe më thellësisht tekstet antike p.sh., dhe jo vetëm ato fetare, por edhe ato të historisë së antikitetit, do të vërejmë, ca herë, edhe qartazi, se pjesë të tëra të ndonjë teksti nuk i përgjigjen fare origjinalit të përkthyer. Ky fenomen na bën të mendojmë se prapa këtyre përkthimeve ka ndonjë qëllim mirë të arsyetuar për të vepruar në atë mënyrë dhe nuk ka të bëjë me atë që quhet *lapsus calami* të autorit apo gabim të shtypshkruesit. Lënda e Filologjisë na mëson se gabime të tilla mund të jenë edhe të qëllimshme...

Por, duhet të mbajmë parasysh edhe faktin ku për shkakun e kontaktit të ngushtë të më shumë gjuhëve në një realitet shoqëror të përbashkët me më tepër etni, mund të ngjajë që edhe të huazohen, nga gjuhët në kontakt, edhe lema të tëra dhe thjeshtë të përkthehen së pari aty për aty sa që më pastaj edhe të zënë vend në të folurën e një komuniteti dhe për më tepër edhe të konsiderohen (fjalët apo konceptet e huazuara) si të mira, të ngjashme apo të përafërta dhe të përshtatshme për gjuhën që i huazon. Është rasti eklatant i shprehjes *Pak a shumë*, që është tipike e shqipes dhe që tentohet gjithnjë e më shumë të zëvendësohet, tanimë, me atë të gjuhës maqedonishte «*zope do ly*», duke e shndërruar në 'poshtë-lartë' apo edhe 'lartë-poshtë', me një këmbëngulje të çuditshme saqë ta bëjnë të jetë më 'simpatike' dhe më tërheqëse lema e huaj në vend të asaj të shqipes *pak a shumë* aq të natyrshme edhe nga aspekti psiko-social. Nuk na duket që këtë shprehje ta përdorin në Shqipëri dhe atë jo për faktin se në italishte thuhet «*più o meno*», në frëngjishte «*plus ou moins*», «*more or less*», etj., etj., në gjuhët tjera, por për faktin se në gjuhën shqipe rezulton të jetë një shprehje më e natyrshme dhe ndoshta edhe tepër e moçme. Këtë huazim nga gjuha maqedonishte e sotme (por, e dimë që edhe në gjuhët tjera sllave të thuhet *pak a shumë* njëjtë), vërejmë që më së shumti ta përdorin politikanët dhe gazetarët, por, që ka filluar të ndikojë dukshëm edhe te folësit më pak të shkolluar, te masa e popullit, duke menduar që i imitojnë më të shkolluarit. Është ky një fenomen gjuhësor që zhvillohet në një mënyrë të paqhtë, ndoshta edhe i pa hetuar nga vet përdoruesit, por, që mund të zërë vend të fortë sa që edhe ta zëvendësojë edhe vetë termin origjinal të gjuhës shqipe. Ky fenomen i fundit, ka shumë gjasa që ta ketë pikënisjen te ndonjë përkthyes i keq dhe të cilit shumë pak i intereson fenomeni gjuhësor dhe pasojat që ai përkthim i tij/saj mund t'i prodhojë gjuhës amtare, por më shumë i intereson tejkalimi i situatës së çastit dhe përfitimi nga 'puna' që e bën. Dhe, kur, pas treqind apo pas pesëqind vitesh, dikush, ndonjë studiues, do të 'guxonte' ta përshkruajë ecurinë e kësajsoji faktesh, do të shpallej i çmendur! Si na paska qenë e mundur që të ngjajë një fakt gjuhësor i këtillë vetëm për një përfitim banal? Pra, na rezulton gati e pamundur që të përmirësohet më, ndonjëherë.

3. Konkludim

Shkenca por edhe ligji nuk e njeh injorancën! Prandaj pyetja, si pasojë, na lind spontane: sa raste të këtilla të fenomenit gjuhësor dhe në veçanti të të përkthyerit si profesion mund të kenë ngjarë në të shkuarën dhe atë në secilën lëndë të shkencës?! Dhe sa mund të riparohen më ato sot? A mund të vihen në diskutim më? Ja se sa punë e mundimshme rezulton të jetë të përkthyerit dhe sa e nevojshme është ajo përgatitja profesionale e atyre që duan dhe duhet të merren me këtë profesion. Nëse një keqkuptim apo edhe një përkthim i gabuar ka bërë që para ca deceniesh të hidhet një bombë atomike dhe që për pak minuta të shkatërrojë jetën e qindra e mijëra njerëzish, një përkthim i tillë mund të shkatërrojë edhe memorien e një gjuhe dhe vijimisht edhe të një populli. Por, kur diçka të këtillë e bëjmë me nismën tonë, për shkaqe të injorancës, atëherë, është dy herë tragjike. Për ndonjë vështrues a studiues mund të duket edhe komike. “Kush i provokon të keqen vetes, le të qajë vetveten!” thotë një fjalë e urtë. Pasi që, për më tepër, gjuha si mjet komunikimi është pronë e të gjithëve dhe në të njëjtën kohë edhe pronë e askujt.

Referencat

- [1]. Romolo Giovanni Capuano, *111 errori di traduzione che hanno cambiato il mondo*, Ed. Eretica Speciale, Viterbo 2013.
- [2]. Autorë të ndryshëm, *Hermeneutics and Science: Proceedings of the First Conference of the International Society for Hermeneutics and Science*, (DIETER FREUNDLIEB, *The difference between science and hermeneutics: Habermas's theory of the necessarily normative nature of linguistic interpretation*), pp. 299-305, p.303 Springer Netherlands, 1999.
- [3]. Sylvian Granger, Jacques Lerot, Stephanie Petch-Tyson, *Corpus-based Approaches to Contrastive Linguistics and Translation Studies*, Rodopi, 2003.